



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**KËSHILLI I MINISTRAVE
KËSHILLI KOMBËTAR I TERRITORIT DHE UJIT**

V E N D I M

Nr. 09 datë 28.05.2025

PËR

MIRATIMIN E LEJES SË NDËRTIMIT PËR OBJEKTIN: “QENDRA E MONITORIMIT TË TRAFIKUT, FAZA II”, ME VENDNDODHJE NË BASHKITË MALËSI E MADHE, SHKODËR, VAU I DEJËS, LEZHË, KURBIN, FIER, MALLAKASTËR, MEMALIAJ, TEPELENË, GJIROKASTËR, DROPULL, VLORË DHE HIMARË

Në mbështetje të neneve 27, 28, 39 të Ligjit Nr. 107/2014, datë 31.07.2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, i ndryshuar; Vendimit Nr. 408, datë 13.05.2015 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, i ndryshuar; Vendimit Nr.519, datë 20.09.2017 të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e përbërjes së Këshillit Kombëtar të Territorit” i ndryshuar, me propozim të zhvilluesit Autoritetit Rrugor Shqiptar (ARRSH), Këshilli Kombëtar i Territorit dhe Ujit,

VENDOSI:

1. Miratimin me kusht të Lejes së Ndërtimit për objektin: “Qendra e Monitorimit të Trafikut, Faza II”, me vendndodhje në Bashkitë Malësi e Madhe, Shkodër, Vau i Dejës, Lezhë, Kurbin, Fier, Mallakastër, Memaliaj, Tepelenë, Gjirokastrë, Dropull, Vlorë dhe Himarë, me zhvillues Autoritetin Rrugor Shqiptar.
2. Harta e Planvendosjes së Strukturave i bashkëlidhet këtij vendimi si pjesë përbërëse e tij.
3. Dokumenti i Lejes së Ndërtimit i jepet kërkuarit vetëm pas:
 - a) plotësimit të dokumentacionit tekniko-ligjor;
 - b) pagesës së taksës së ndikimit në infrastrukturë për llogari të Bashkive Malësi e Madhe, Shkodër, Vau i Dejës, Lezhë, Kurbin, Fier, Mallakastër, Memaliaj, Tepelenë, Gjirokastrë, Dropull, Vlorë dhe Himarë
4. Ngarkohet Agjencia e Zhvillimit të Territorit dhe Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë për zbatimin e këtij vendimi.
5. Vendimi, pasi nënshkruhet nga Kryetari i Këshillit Kombëtar të Territorit, Ministri i Linjës dhe Sekretari i Këshillit Kombëtar të Territorit, hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI

EDI RAMA



MINISTËR I LINJËS
MINISTËR I INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË
BELINDA BALLUKU



ANËTAR / SEKRETAR I KKTU-SË
DREJTOR I AGJENCISË SË ZHVILLIMIT TË TERRITORIT
ADELAJDA ROKA



Nënshkruar më datë 11 /07/ 2025